

Në mbështetje të nenit 12 par. 1.1 dhe nenit 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës:

SHPALL KONKURS

Titulli i vendit të punës:	Një (1) Zyrtar Ekzekutiv
Departamenti	Zyra e Drejtorit të përgjithshëm
Kategoria funksionale dhe grada:	AAC-5
Pozitë:	Jo i karrierës (me mundësi vazhdimi pas dy vite)
Nr. i referencës së vendit të punës:	AACK-ADM-BNJ/01/2018
Vendi:	AAC, Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm:

Koordinimi dhe ofrimi i mbështetjes së Drejtorit të përgjithshëm në kryerjen e të gjitha funksioneve ekzekutive dhe administrative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Organizimi dhe përcjellja e funksionimit të mirë të Zyrës së Drejtorit të përgjithshëm dhe bashkëpunimi me departamentet dhe zyrat, sipas udhëzimeve të DP, lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të punës brenda afateve kohore.
2. Verifikimi i saktësisë, nga aspekti formal i materialeve të trajtuara nga strukturat përgjegjëse në AAC, para nënshkrimit të tyre nga Drejtori i përgjithshëm.
3. Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për Drejtorin e përgjithshëm.
4. Organizimi dhe përgatitja e mbledhjeve dhe takimeve që drejtohen nga Drejtori i përgjithshëm dhe mbajtja e procesverbalit gjatë takimeve javore të menaxhmentit.
5. Koordinimi brenda atributëve të dhëna, i raporteve me institucionet shtetërore, dhe ndërkombëtare dhe entitetet tjera publike apo private.
6. Zbatimi i protokollit zyrtar sipas ligjit në fuqi.
7. Informon stafin për vendimet e Drejtorit të përgjithshëm
8. Kryen punë të tjera sipas përgjegjësisë së pozitës

Shkollimi i kërkuar:

Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, juridikut, dhe administratës.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në Republikën e Kosovës
- Të ketë rrjedhshmëri në të folur dhe shkruar në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.
- Të ketë aftësi për të mbajtur shkallën më të lartë të diskrecionit.
- Të jetë person me iniciativë, tolerancë dhe durim dhe aftësi për të punuar nën presion kohor.
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinim.
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point,

Access);

Dokumentet që duhen për aplikim:

Diploma e fakultetit(kopje) e noterizuar
Dëshmi për përvojën e punes (kopje) të konfirmuara
Dëshmi për kurse të gjuhës dhe kurse të tjera (kopje)
Leternjoftimi (kopje)
Dokumentet e pa kompletuara nuk shqyrtohen

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës, personat e moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprimit, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësi fizike dhe profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen nga pozitat përkatëse.

Procedurat e rekrutimit:

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë shërbyesit civilë ekzistues dhe personat e jashtëm të cilët i plotësojnë kushtet e nevojshme për konkurim.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Procesi i rekrutimit për këtë lloj pozite është i bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe Rregulloren e brendshme të AACK-së.

Të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara, do t'i nënshtrohen shqyrtimin fillestar të aplikacioneve të tyre. Vetëm kandidatët të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë, do të kontaktohen.

Kohëzgjatja e Aktemërimit:

Pozitë Jo e karrierës për periudhën dy vjeqare me mundësi vazhdimi

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data 01.09.2018 - 15.09.2018 e shpalljes në gazeta të përditshme kosovare dhe në faqen zyrtare të AACK-së në internet. Data e fundit për aplikim është 15.09.2018 deri në ora 16:00, të gjitha aplikacionet e kompletuara, të dërguara deri më këtë datë, do të konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave:

Formularët e aplikimit mund të merren nga faqja zyrtare e AACK-së në internet, në <http://caa-ks.org/category/lajme/> ose në selinë e AACK-së, Rr. Ahmet Krasniqi Nr.208, Lagja Arbëria, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, deri në ditën e fundit për konkurim.

Aplikacionet dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet personale mund të dorëzohen nëpërmes postës elektronike në e-adresën: **Sadete.R.Krasniqi@caa-ks.org** ose në adresën postare të cekur më lart, me shënimin "**Për rekrutim - pozita në të cilën konkuroni**". Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në numrin 038 248 629 lok. 115.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.